



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal

i mbajtur më 05 mars 2026, në mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VIII, për nderë të Shënimit të 28 vjetorit të “EPOPEË së UÇK-së” me qëllim shënimin, promovimin e vlerave të luftës së UÇK-së dhe kontributin e Familjeve të Dëshmorëve për lirinë e Kosovës

Mbledhja filloi në orën 10:10 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit.

Në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV: *Adelina Stublla; Artrit Mulliqi; Fatri Zhitija; Kasib Bashota; Valdet Kamerolli; Arbrim Kunushaj; Flandra Kadriu; Luljeta Muçolli-Azemi; Vlora Jashanica; Haki Rudari; Abedin Zeka; Qëndresë Hajrizi; Ardi Hasani; (munguan; Florent Hasani; Avni Islami).*

Nga LDK: *Enis Shabani; Alisa Jetullahu; Enis Dervisholli; Besim Latifi; Valdet Restelica; Blerta Azemi-Berisha; Ermal Osmani; Gresa Qosa-Maçastena; Arben Xhemajli; (munguan; Valon Demolli; Ekrem Rrahmani; Arnisa Sylejmani; Isak Ejupi).*

Nga PDK: *Lulzim Pollomi; Mimoza Abdullahu, (mungoi; Rinesa Goxhufi).*

Nga Guxo: *mungoi Demokrat Hodolli.*

Nga Unioni i Blakçorëve-UB: *Gentrit Arifi.*

Nga AAK: *Baki Feta.*

Të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin: z.Fahri Restelica Nënkryetari i Komunës;

U.D. drejtorët e Drejtorive të Komunës dhe atë:

Arbnorë Uka Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Ahmet Ahmeti-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Valbona Azemi-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS dhe e Autorizuar përkohësisht për ushtrimin e funksionit të Drejtoreshës së Drejtorisë së Administratës deri në kthimin e U.D drejtoreshës së kësaj Drejtorie nga pushimi; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Behram Latifi-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE.

Të pranishëm tjerë ishin; Bekim Zhdrella, Xhemshit Gashi dhe Hamit Hamiti përfaqësues nga Shoqatat e Dala nga Lufta e UÇK-së; Nuredin Ibishi ish Komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Llapit; Bashkim Bajrami Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë; Mensur Hoti dhe Idriz Bilalli nga Këshilli i Bashkësisë Islame-Podujevë; Familjar të Heronjve Afrim Zhitia dhe Ali Ajeti; Media Lokale TV-Llapi, dhe një numër i zyrtarëve komunale.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen, duke i'u dëshiruar të pranishmëve mirëseardhje në këtë mbledhje Solemne për nder të Shënimit të 28 vjetorit të EPOPESE së UÇK-së me qëllim shënimin, promovimin e vlerave të luftës së UÇK-së dhe kontributin e Familjeve të Dëshmorëve për lirinë e Kosovës, theksoi, të nderuar të pranishëm, në shenjë nderimi për Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ju ftoj që fillimisht të ngrihemi në këmbë për respektuar intonimin e Himnit Kombëtar dhe atij Shtetëror.

Mbledhja u hap me Intonimin e Himnit të Republikës së Kosovës dhe Himnit të Republikës së Shqipërisë-Himni Kombëtar

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, vazhdoi, të nderuara Familje të Dëshmorëve, Invalidë dhe veteranë të UÇK-së, përfaqësues të Shoqatave të Dala nga Lufta e UÇK-së Bekim Zhdrella dhe Xhemshit Gashi, i nderuari ish Komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për Zonën Operative të Llapit Nuredin Ibishi, i nderuari Komandant i Policisë Kapiten Bashkim Bajrami, i nderuari Kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë Imam Mensur Hoti, i nderuari Imam Idriz Bilalli dhe Imam Idriz Bilalli, i nderuari Nënkrjetar i Komunës zotëri Fahri Restelica, të nderuar drejtorë të Drejtorive të Komunës, të nderuar anëtarë të Kuvendit, të nderuar përfaqësues të Mediave, të dashur qytetarë, zonja dhe zotërinj.

Në bazë të agjendës për shënimin e 5, 6 dhe 7 Marsit Epopesë së UÇK-së, dhe në përputhje me përgjegjësitë tona institucionale, shpall të hapur mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunës kushtuar Epopesë së lavdishme të UÇK-së.

Kjo mbledhje solemne organizohet për të nderuar sakrificën sublime të Dëshmorëve dhe Martirëve të Kombit, për të kujtuar momentin historik 5, 6 dhe 7 marsit 1998 dhe për të riafirmuar përkushtimin tonë ndaj vlerave të lirisë, shtet ndërtimit dhe dinjitetit Kombëtar.

Të nderuar të pranishëm, Ju ftoj që të ngrihemi në këmbë dhe të mbajmë një minutë heshtje në nderim të të gjithë Dëshmorëve dhe Martirëve të Kombit, të rënë për lirinë e Kosovës.

Mbahet 1 minutë heshtje në nderim të të gjithë dëshmorëve dhe martirëve të kombit, të rënë për lirinë e Kosovës.

Lavdi e përjetshme

• Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z.Isak Shabani, Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, të nderuar të pranishëm, të dashur qytetarë, sot jemi mbledhur për të kujtuar dhe nderuar një nga faqet më të ndritura të historisë sonë Kombëtare Epope-në e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Epopeja e UÇK-së nuk është thjesht një kapitull lufte, ajo është një kapitull i ndërjegjjes sonë Kombëtare, në themelet e kësaj Epopeje qëndron sakrifica sublime e Familjes Jashari, në krye me Komandantin legjendar Adem Jashari.

Ka momente në historinë e një kombi që nuk maten me kohë, por maten me gjak, 5, 6 dhe 7 marsi janë pikërisht ato ditë. Aty u zhvillua një betejë e pabarabartë por madhështore, një betejë titanike mes një familjeje që kishte vendosur të mos dorëzohej dhe një makinerie të tërë ushtarake që kërkonte nënshtrim, dhe në krye të asaj qëndrese qëndronte Komandanti Legjendar Adem Jashari, ai nuk zgjodhi jetën e lehtë, ai zgjodhi lirinë, ai nuk zgjodhi kompromisin, por e zgjodhi përjetësinë.

Shtëpia e Jasharëve nuk ishte vetëm një kullë guri, ajo u bë kala e dinjitetit Kombëtar, aty nuk u mbrojt vetëm një familje, aty u mbrojt nderi i një kombi, dhe kur ranë Jasharët, nuk ra Kosova, u ngrit Kosova, gjaku i tyre nuk mbolli frikë por mbolli kryengritje, mbolli vendosmëri, mbolli ushtri.

Nga ajo ditë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ishte më vetëm një formacion i armatosur, ajo u bë zemra që rrihte në çdo shtëpi të Shqipëtarëve, u bë betim i çdo të riu, u bë shpresa e çdo nëne.

Por kjo Epope nuk nisi vetëm në Prekaz, ajo kishte filluar më herët, me rënien heroike të Komandantit Zahir Pajaziti me shokët e idealit. Zahiri ishte ndër të parët që e kuptoi se liria kërkon organizim, guxim dhe sakrificë, ai ishte ndër themeluesit e frymës së rezistencës së armatosur, rënia e tij nuk e ndali lëvizjen, e forcoi atë, e bëri më të qartë rrugën drejt përballjes së hapur.

Zahiri ishte kushtrim, Ademi ishte shpërthim, pra e përsërisë edhe njëherë këtë se Zahiri ishte kushtrim, Ademi ishte shpërthim.

Prekazi ishte kthesa e pakthyeshme, pas 5, 6 dhe 7 marsit, historia mori drejtim tjetër, pas Prekazit, mijëra të rinj iu bashkuan radhëve të UÇK-së dhe lufta mori përmasa të reja, Bota filloi të kuptojë se në Kosovë nuk kishte “krizë të brendshme” por kishte një popull që kërkonte lirinë, dhe një popull që vendos të vdesë për liri, nuk mund të jetojë në robëri.

Të nderuar të pranishëm, Epopeja e UÇK-së duhet të trajtohet me maturi historike dhe seriozitet akademik, Epopeja e UÇK-së nuk është mit për konsum politik, është realitet historik i dokumentuar, Epopeja e UÇK-së është kapitulli më i lavdishëm i rezistencës sonë Kombëtare, i vulosur me gjak, me sakrificë dhe vendosmëri.

Në marsin e vitit 1998, në Prekaz, me rënien heroike të Adem Jashari dhe Familjes së tij, u dëshmuua para Botës se liria nuk fitohet me lutje, por fitohet me qëndresë, aty u shndërrua një shtëpi në kala dhe një familje në simbol të përjetshëm të lirisë.

Epopeja dëshmon se, një popull mund të organizohet për liri, edhe kur duket i vetëm përballë një makinerie të fuqishme shtypëse, një sakrificë individuale bëhet themel i lirisë kolektive, se kur cenohen dinjiteti dhe e drejta për të jetuar i lirë, rezistenca bëhet obligim moral.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk lindi nga ambicia për pushtet, por nga nevoja për mbijetesë dhe dinjitet, ajo lindi nga plagët e padrejtësisë, nga përndjekjet, nga mohimi i të drejtave elementare, dhe pikërisht për këtë, Epopeja e saj është dëshmi e vullnetit të pathyeshëm të një populli për të qenë zot në shtëpinë e vet.

Sot, përkujtimi i kësaj Epopeje të lavdishme të UÇK-së nuk është glorifikim i luftës, por nderim i sakrificës për liri, sepse liria nuk është pikëmbërritje por është proces, sot përgjegjësia është mbi ne, sepse Epopeja nuk përfundoi me çlirimin, ajo vazhdon në ndërtimin e shtetit, në mbrojtjen e vlerave të luftës, në edukimin e brezave me të vërtetën historike.

Ne nuk guxojmë ta lejojmë që kjo histori të zbehet, as të keqpërdoret e as të shtrembërohet, sepse UÇK-ja ishte bashkim, ishte sakrificë dhe ishte ideal.

Sot përulemi me respekt para Familjeve të Dëshmorëve, para nënave që rritën heronj, para baballarëve që nuk u përkulën, para fëmijëve që u rritën me mungesë, por me krenari.

Le ta themi fuqishëm se me të vërtetë Liria ka emra, ka varre, dhe ka histori, dhe historia jonë ka një emër që shkëlqen në përjetësi Ushtria Çlirimtare e Kosovës, po e përsërisë historia jonë ka një emër që shkëlqen në përjetësi Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Lavdi e përjetshme Komandantit Legjendar Adem Jashari, Komandantit Zahir Pajaziti, lavdi gjithë Dëshmorëve të Kombit, lavdi Epopesë së UÇK-së.

Ju faleminderit.

Të nderuar të pranishëm, pasi që Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi gjendet në një vizitë zyrtare në Angli, kemi nderin t'ia japim fjalën Nënkryetarit të Komunës z.Fahri Restelica.

• Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës

(në emër të Kryetarit të Komunës z.Shpejtim Bulliqi i cili gjendet në udhëtim zyrtar jashtë vendit fjalën e rastit e paraqiti Nënkrjetari i Komunës)

z.Fahri Restelica, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, të nderuar pjesëmarrës, të nderuara Shoqata të dala nga lufta, të nderuar Familjarë të Dëshmoreve, të nderuara Familje Ajeti, Zhitia, të nderuar përfaqësues të Shoqatës së ish të burgosurve politik, i nderuar Kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame Mensur Hoti, i nderuari Hoxhë Idriz Bilalli, i nderuari Komandant i Stacionit të Policisë, i nderuari ish shef i Shtabit të UÇK-së në Zonën Operativa të Llapit z.Nuredin Ibishi-Leka, të nderuar qytetarë, të nderuar Asambleistë, shefa të Grupeve politike të Kuvendit, sot jemi mbledhur në një moment të veçantë për të përkujtuar dhe nderuar jetën dhe veprën e Adem Jasharit, një nga figurat më të shquara të historisë sonë të re Kombëtare, simbolin e qëndresës, guximit dhe dashurisë së pakushtëzuar për atdheun. Përmes sakrificës së tij dhe Familjes së tij, ne kujtojmë jo vetëm luftën për liri, por edhe forcën e identitetit që e ka mbajtur gjallë popullin Shqiptar ndër shekuj.

Historia jonë është histori qëndrese, që nga Gjergj Kastriotit Skënderbeu i cili për 25 vite mbrojt trojet Shqiptare dhe u bë simbol i rezistencës së Shqiptarëve por edhe Evropiane, e deri te Rilindja Kombëtare, ku rilindas si Sami Frashëri ngritën pyetjen e madhe në atë kohe “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e çdo të bëhet” duke ngritur vetëdijen Kombëtare në një nivel të ri dhe duke theksuar se bashkimi, arsimit dhe ndërgjegjja Kombëtare janë themel i lirisë, derisa një tjetër rilindas Naim Frashëri i dha shpirt Kombit me vargjet e tij “Ti Shqipëri, më jep nder, më jep emrin Shqiptar”, të cilat edhe u edhe bënë betim për shume breza, dhe pikërisht ky mendim i Samiut dhe ky shpirt i Naimit gjetën mishërim të plotë në jetën dhe sakrificën e Adem Jasharit. Ajo që Samiu e artikuloi si detyrë Kombëtare dhe që Naimi e lartësoi si dashuri të shenjtë për Atdheun, Adem Jashari e ktheu në veprim dhe flijim.

Shekulli XIX solli Lidhjen e Prizrenit si përpjekjen e parë të organizuar për mbrojtjen e trojeve.

Shekulli XX solli shpalljen e Pavarësisë nga Ismail Qemali më 1912, por edhe një padrejtësi historike që e lanë Kosovën jashtë kufijve të Shqipërisë nën represion për dekada të tëra, burgosje, ndalime, mohim të gjuhës dhe identitetit, por asnjëherë nuk u dorëzuam.

Siç do të theksonte Ismail Kadare, liria për Shqiptarët nuk ka qenë kurrë dhuratë, por gjithmonë e fituar me sakrificë, dhe pikërisht në këtë vazhdë historike, fundi i shekullit XX shënoi një nga kulminacionet më të mëdha të historisë sonë, qëndresën e familjes Jashari në Prekaz, ajo nuk ishte thjesht një betejë, ishte një akt vetëflijimi që tronditi ndërgjegjen e Kombit dhe të Botës, një familje e tërë u bë simbol i lirisë.

Nelson Mandela do të thoshte, “Unë mësova se guximi nuk është mungesa e frikës, por triumfi mbi të”. Në Prekaz, frika nuk u zhduk, ajo u sfidua, dhe ishte Adem Jashari ai që e shndërroi atë frikë në forcë, në betim për një liri, në një akt që e ngriti sakrificën në pedestalin e pavdekësisë, Prekazi nuk ishte vetëm vend beteje, ishte altar i lirisë sonë.

Martin Luther King, do të shprehje, “Nëse një njeri nuk ka zbuluar diçka për të cilën është i gatshëm të vdesë, ai nuk është i denjë të jetojë”, Adem Jashari e kishte zbuluar atë ideal, lirinë e popullit të tij. Derisa Mahatma Gandhi na kujton se liria është e drejtë natyrore e çdo populli, lufta e Adem Jasharit dhe sakrifica e Familjes Jashari e bëri këtë të vërtetë të dukshme për mbarë njerëzimin, se dinjteti nuk negociohet dhe liria nuk nënshtrohet.

Nëse e shohim historinë tonë si një lumë të gjatë sakrifice, atëherë Prekazi është pika ku ky lumë u shndërrua në stuh, nga Skënderbeu te Rilindja, nga Pavarësia e Shqipërisë deri te rezistenca paqësore dhe deri te lufta për çlirim e UÇK-së, të gjitha këto faza kulmuan me aktin sublim të familjes Jashari.

Le ta kujtojmë sot Adem Jasharin jo vetëm si Hero të Kosovës, por si simbol i një historie të tërë që dëshmon se për Shqiptarët liria ka qenë gjithmonë ideal mbi jetën, sepse historia nuk është vetëm kujtesë, është përgjegjësi, dhe përgjegjësia jonë është ta ruajmë, ta forcojmë dhe ta zhvillojmë lirinë e fituar me gjakun e më të mirëve tanë.

Lavdi e përjetshme Adem Jasharit dhe Familjareve të rën dhe të gjithë Dëshmorëve të Kombit.

z.Isak Shabani, Kryesuesi i Kuvendit, duke falënderuar Nënkryetarin e Komunës për fjalën e rastit, theksoi, tani gjithashtu kam nderin ta ftoj për një fjalë rasti një personalitet që ishte në vijën e partë të frontit, Komandantin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovë për Zonën Operative të Llapit i cili e ka nderuar mbledhjen e pjesëmarrjen e tij, z.Nuredin Ibishi, urdhëroni fjala për Ju.

- **Fjalë rasti nga ish Shefi i Shtabit të UÇK-së në Zonën Operative të Llapit z.Nuredin Ibishi**

z.Nuredin Ibishi, ish shef i Shtabit të UÇK-së në Zonën Operative të Llapit, theksoi, përshëndetje për të gjithë juve, përshëndetje për Kryesuesin e Kuvendit Isak Shabani dhe për Nënkryetarin e Komunës Fahri Restelica, përshëndes për drejtorët/shat e Drejtorive të Komunës, ju asamblistë, familjar të Dëshmoreve familjet Ajeti e Zhitia, prirës fetar z.Idriz Bilalli dhe të tjerë, i nderuar Xhemshit Gashi, pastaj ju i nderuar Komandant i Stacionit Policor, i nderuar z.Hamit Hamiti të cilit i kemi thënë Bali në atë kohë, si dhe për Bekim Zhdrellën nga Shoqata e Invalidëve të Luftës.

Sot në këtë mbledhje solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës përulemi me nderim të thellë para veprës madhore të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe sakrificës sublime të Komandantit legjendar Adem Jashari dhe Familjes Jashari. Rënia heroike e Komandantit Adem Jashari dhe Familjes së tij nuk ishte vetëm një akt unik i qëndresës por ishte një kthesë historike që i dha shpirt dhe drejtim luftës sonë për liri, ajo sakrificë u bë frymëzim për mijëra djem dhe vajza të Kosovës që t'iu bashkohen radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për çlirimin e atdheut.

Në këtë përvjetor të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kujtojmë me respekt të përjetshëm Dëshmorët dhe Martirët e Kombit si dhe familjet e tyre të cilët mbajtën barrën më të madhe të luftës, kujtojmë çdo qytetarë të Kosovës që kontribuoj me guxim, përkushtim dhe sakrificë për lirin që ne sot gëzojmë.

Shqipëria na qëndroj në përkrahje të vazhdueshme dhe me përkushtim si një Komb unik deri në liri. Njëkohësisht shpreh mirënjohje të thellë për përkrahjen vendimtare të aleatëve ton ndërkombëtar e veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës me NATO-në dhe vendeve demokratike të cilat qëndruan përkrah popullit të Kosovës në momentet më të vështira dhe ndihmuan në kurorëzimin e përpjekjeve tona për liri.

Si ish shef i Shtabit të Zonës Operative të Llapit, zonës më të madhe dhe më profesionale në Kosovë e ndjej si detyrë morale dhe kombëtare të dëshmoj se lufta jon ishte e drejtë e pastër dhe e mbështetur mbi idealin e lirisë dhe dinjitetin njerëzor.

Uroj që çlirimtarët ton që po gjykohen në Hagë të lirohen duke dëshmuar se ishin pjesë e misionit të drejtë dhe të ndritshëm për lirin e Kosovës.

Sot përgjegjësia jon është ta ruajmë këtë trashëgimi me unitet drejtësi dhe integritet dhe përkushtim ndaj shtet ndërtimit.

Lavdi e përjetshme Komandantit legjendar Adem Jashari dhe Familjes Jashari, Lavdi heroit Zahir Pajazitit dhe Dëshmorëve të Kombit, nderime Martirëve të Kosovës, qoftë i përjetshëm kujtimi i tyre dhe bekuar liria e Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit, duke e falënderuar parafolësin për fjalën e rastit, vazhdoi, të nderuar të pranishëm, duke ju falënderuar për pjesëmarrjen dhe për nderimin që i bëtë sot Epopesë së UÇK-së dhe Dëshmorëve të Kombit, shpalli të mbyllur këtë mbledhje Solemne të Kuvendit të Komunës.

Lavdi e përjetshme Dëshmorëve.

Zoti e bekoftë Kosovën.

Faleminderit dhe mirupafshim në takimet tjera.

Konstatohet e përfunduar kjo mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 10:25

**Procesverbalin e mbajti dhe hartoi;
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0013330/26
Podujevë, 05 mars 2026**

**Kryesuesi i Kuvendit
Isak Shabani**